



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE  
SEKTORI I NDIHMËS DHE KOORDINIMIT TË INFORMACIONIT**

Nr. 1533 Prot.

Tiranë, më 12 . 05 .2026

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

**TË VENDIMIT NR. 3324/1 PROT., DATË 23.01.2026 TË INSPEKTORIT TË  
LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË  
ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASI Z. GJON PUKA PËRSA I  
TAKON PRETENDIMEVE NDAJ MAGJISTRATES A. LL. DHE  
PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PA NJË VENDIM  
PËRFUNDIMTAR SA I TAKON PRETENDIMEVE NDAJ ISH-  
MAGJISTRATIT A.Y”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga z. Gjon Puka, me nr. 622 prot., datë 30.04.2020, në të cilën ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë së magjistratëve A.Ll., dhe A.Y., me detyrë gjyqtarë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Shkodër, në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur dhe me vendimin nr. 3324/1 prot., datë 23.01.2026, “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Gjon Puka përsa i takon pretendimeve ndaj magjistrates A.Ll., dhe përfundimin e procedurës së verifikimit pa një vendim përfundimtar sa i takon pretendimeve ndaj ish-magjistratit A.Ymeri”, bazuar në nenin 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, nenet 74, 77 dhe nenin 122 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e deklaruar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë të Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Shkodër, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Rruga “Ura e Madhe”, Shkodër;

- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al)

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

## SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

**Dëshira Pasko**

